



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 38

2003

Maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9051 datë 17.4.2003	Për ratifikimin e “Konventës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës për shmangien e taksimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal.....	1279
Ligj nr.9052 datë 17.4.2003	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Protokollin shtesë të “Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”.....	1296
	Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë, datë 17.4.2003.....	1296

L I G J
Nr.9051, datë 17.4.2003

PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË BELGJIKËS PËR SHMANGIEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË, LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN DHE PËR PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës për shmangien e taksimit të dyfishtë, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3794, datë 24.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTË

NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË BELGJIKËS PËR SHMANGIEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN DHE PËR PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës:
duke dëshiruar, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm dhe lehtësimin e marrëdhënieve të tyre ekonomike, të përfundojnë një Konventë për eliminimin e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal,
kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1

Fushëveprimi i Konventës

Kjo Konventë do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njërit ose e të dy Shteteve Kontraktuese.

Neni 2

Tatimet që mbulon Konventa

1. Kjo Konventë do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të zbatuara në emër të një Shteti Kontraktues, një nënndarje politike ose autoritetet e tij lokale, pavarësisht nga mënyra e vjeljes së tyre.
2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet e vendosura

mbi të ardhurat totale, mbi kapitalin në total ose mbi elemente të të ardhurave ose të kapitalit, përfshirë tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi shumat totale të pagave të paguara prej punëdhënësve, si edhe tatimet mbi rivlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese, ndaj të cilave do të zbatohet Konventa, janë në veçanti:

a) Në Shqipëri:

- i) tatimi mbi fitimin e personave juridikë;
 - ii) tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël;
 - iii) tatimi mbi të ardhurat personale;
 - iv) tatimi mbi pasurinë;
- (në vijim do t'u referohemi si "tatimet shqiptare").

b) Në Belgjikë:

- i) tatimi mbi të ardhurat personale;
 - ii) tatimi mbi të ardhurat e korporatave;
 - iii) tatimi mbi të ardhurat e personave juridikë (subjekte jofitimprurëse);
 - iv) tatimi mbi të ardhurat e jorezidentëve;
 - v) kontributet suplementare për krizat, përfshirë parapagimet, mbipagesat mbi këto tatime dhe pagesat në avancë, si dhe shtesat e tatimit mbi të ardhurat personale;
- (në vijim do t'u referohemi si "tatimet belge").

4. Konventa do të zbatohet gjithashtu për çdo tatim të njëlojtë ose tepër të ngjashëm, të cilët do të vendosen pas datës së nënshkrimit të Konventës si shtojcë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim thelbësor që është bërë në ligjet e tyre përkatëse tatimore.

Neni 3

Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe:

a) Termi "Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe, kur përdoret në sensin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si dhe çdo zonë tej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe me ligjet e saj, është një zonë, brenda së cilës Republika e Shqipërisë ushtron të drejtat e saj në lidhje me tabanin detar, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore.

b) Termi "Belgjika" nënkupton Mbretërinë e Belgjikës dhe, kur përdoret në sensin gjeografik, nënkupton territorin e Mbretërisë së Belgjikës, përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirat e tjera në det dhe në ajër, mbi të cilat Mbretëria e Belgjikës, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, ushtron të drejtat sovrane apo juridiksionin e vet.

c) Termat "Shtet Kontraktues" dhe "Shteti tjetër Kontraktues" nënkuptojnë Shqipërinë ose Belgjikën, siç e kërkon përmbajtja.

d) Termi "person" përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo grup tjetër personash.

e) Termi "shoqëri" nënkupton çdo ent ligjor, i cili trajtohet si person juridik për qëllime tatimore në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit ai është.

f) Termat "sipërmarrje e një Shteti Kontraktues" dhe "sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues" nënkuptojnë respektivisht një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues.

g) Termi "nënshtetas" nënkupton:

- i) çdo individ që zotëron nënshtetësinë e një Shteti Kontraktues;
- ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqatë që gëzojnë statusin si të tillë, në përputhje me ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues.

h) Termi "trafik ndërkombëtar" nënkupton çdo transport me anije, avion ose mjet rrugor, ose hekurudhor, që operohet nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues, përveç kur këto mjete transporti veprojnë vetëm ndërmjet vendeve të ndodhura në Shtetin tjetër Kontraktues.

i) Termi "autoritet kompetent" nënkupton:

- i) në rastin e Shqipërisë, Ministrin e Financave ose përfaqësuesin e autorizuar prej tij;
- ii) në rastin e Belgjikës, Ministrin e Financave ose përfaqësuesin e autorizuar prej tij.

2. Përsa i përket zbatimit të Konventës në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term që

nuk është përcaktuar këtu, përveç kur përmbajtja e kërkon ndryshe, do të ketë kuptimin që i është dhënë në atë moment sipas legjislacionit të atij shteti lidhur me tatimet, ndaj të cilave zbatohet Konventa. Çdo kuptim i një termi sipas ligjeve tatimore në fuqi në atë shtet do të ketë prioritet mbi kuptimin që i jepet atij termi në ligje të tjera të atij shteti.

Neni 4 **Rezidenti**

1. Për qëllime të kësaj Konvente, termi “rezident i një Shteti Kontraktues” nënkupton çdo person që, sipas ligjeve të atij shteti, është subjekt i tatimeve atje për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të drejtimit, vendit të regjistrimit ose çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme, dhe gjithashtu përfshin atë shtet dhe çdo nënndarje politike apo autoritet lokal atje. Megjithatë, ky term nuk përfshin personat që i nënshtrohen tatimit në atë Shtet vetëm për të ardhurat e realizuara në atë shtet ose kapitalit të vendosur aty.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1 një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese atëherë statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

a) Ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit në të cilin ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij; në qoftë se ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në të dy shtetet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit, me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetike).

b) Në qoftë se shteti, në të cilin ai ka qendrën e interesave jetike, nuk mund të përcaktohet ose në qoftë se ai nuk ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në asnjërin shtet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i Shtetit Kontraktues në të cilin ai qëndron rregullisht.

c) Në qoftë se ai qëndron rregullisht në të dy shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai do të konsiderohet rezident vetëm i Shtetit Kontraktues, nënshtetas i të cilit ai është.

d) Në qoftë se ai është nënshtetas i të dy shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do ta zgjidhin çështjen me mirëkuptim reciprok.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1 një person juridik është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë ai do të konsiderohet rezident i shtetit në të cilin ndodhet vendi i tij i drejtimit efektiv.

Neni 5 **Selia e përhershme**

1. Për qëllime të kësaj Konvente termi “seli e përhershme” nënkupton një vend fiks biznesi nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht aktiviteti i një sipërmarrjeje.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin në veçanti:

a) një vend drejtimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte;

f) një minierë, një pus naftë ose gazi, një gurore ose çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore.

3. Termi “seli e përhershme” do të përfshijë gjithashtu:

a) një shesh ndërtimi, një konstruksion, projektmontimi ose instalimi, ose projekte mbikëqyrjeje të lidhura me to, por vetëm kur një shesh i tillë, projekte ose aktivitete vazhdojnë brenda këtij vendi për një periudhë prej më shumë se nëntë muaj, brenda çdo periudhe 12- mujore, që fillon ose përfundon në vitin përkatës kalendarik;

b) kryerjen e furnizimit të shërbimeve, përfshirë shërbime konsulence nga një sipërmarrje nëpërmjet të punësuarve ose edhe personeli tjetër të zënë me punë nga sipërmarrja për këtë qëllim, por vetëm kur aktivitete të kësaj natyre vazhdojnë për të njëjtin projekt ose projekte të lidhur me të, brenda vendit për një periudhë ose periudha që në total i kalojnë nëntë muaj brenda çdo periudhe 12-mujore, që fillon ose përfundon në vitin përkatës kalendarik.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni termi “seli e përhershme” nuk do të

përfshijë:

a) përdorimin e mjediseve vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi të mallrave që i përkasin sipërmarrjes;

b) mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi;

c) mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime përpunimi nga një sipërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim blerjen e mallrave ose për mbledhje informacioni për sipërmarrje;

e) mbajtjen e një vendi fiks biznesi për qëllim ushtrimi, për sipërmarrjen, të çdo aktiviteti tjetër me karakter përgatitor ose ndihmës;

f) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët a) deri e), me kusht që i tërë aktiviteti i vendit fiks të biznesit, që rezulton nga ky kombinim, të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person – i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur, ndaj të cilit zbatohet paragrafi 6 – vepron në një Shtet Kontraktues në emër të një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, kjo sipërmarrje do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në shtetin e përmendur në fillim lidhur me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për sipërmarrjen, nëse ky person ka dhe zakonisht ushtron në shtetin e përmendur në fillim një autoritet për të përfunduar kontrata në emër të sipërmarrjes, përveç kur aktivitetet e këtij personi kufizohen në ato të përmendura në paragrafin 4 që, edhe pse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk do ta bënin këtë vend fiks biznesi një seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një sipërmarrje nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në një Shtet Kontraktues, vetëm për faktin se ajo ushtron biznes në këtë shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, komisioneri të përgjithshëm ose çdo lloj agjenti tjetër me një status të pavarur, me kusht që të tillë persona veprojnë brenda kuadrit të zakonshëm të aktivitetit të tyre. Sidoqoftë, kur aktivitetet e një agjenti të tillë kryhen tërësisht ose thuajse tërësisht në emër të asaj sipërmarrjeje, ai nuk do të konsiderohet një agjent me një status të pavarur brenda kuptimit të këtij paragrafi.

7. Fakti që një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues, kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri, që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues ose që ushtron aktivitet në atë shtet tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose në forma të tjera), nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për të konsideruar njërën kompani seli të përhershme të tjetrës.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme

1. Të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuria e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia dhe pyjet) të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues ku është vendosur prona në fjalë. Në çdo rast ky term do të përfshijë pasuritë aksesore të pasurisë së paluajtshme, inventarin e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi e në pyje, të drejtat ndaj të cilave zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm lidhur me pronën mbi tokën, uzufukti i pasurive të paluajtshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse ose variabël për shfrytëzimin ose të drejtën për të shfrytëzuar vendburimet minerare dhe burime e pasuri të tjera natyrore. Anijet dhe avionët nuk konsiderohen pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen ndaj të ardhurave të realizuara nga përdorimi direkt, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurive të paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e një sipërmarrjeje dhe ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e përdorur për kyçjen e shërbimeve personale të pavarura.

Neni 7

Fitimet nga biznesi

1. Fitimet e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë shtet, përveç kur sipërmarrja ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje. Në qoftë se sipërmarrja ushtron aktivitetin në mënyrën e sipërpërmendur, fitimet e sipërmarrjes mund të tatohen në shtetin tjetër, por vetëm ajo pjesë e tyre që i atribuohet asaj selie të përhershme.

2. Nëse një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues:

a) përdor mjedise në Shtetin tjetër Kontraktues vetëm për qëllim shpërndarjeje në atë Shtet Kontraktues të mallrave që i përkasin asaj sipërmarrjeje;

b) mban në Shtetin tjetër Kontraktues gjendje malli që i përket asaj sipërmarrjeje, thjesht për qëllim shpërndarjeje në atë Shtet Kontraktues, atëherë vetëm masa e fitimit që i atribuohet kësaj shpërndarjeje mund të tatohet në Shtetin tjetër Kontraktues.

3. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 4, kur një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, atëherë në secilin Shtet Kontraktues, selisë së përhershme do t'i atribuohen fitimet që ajo do të realizonte, sikur ajo të ishte një sipërmarrje e veçantë dhe e pavarur, që do të vepronte në të njëjtin aktivitet ose në aktivitete të ngjashme, nën kushte të njëjta ose të ngjashme dhe vepron tërësisht e pavarur.

4. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, do të lejohet zbritja e shpenzimeve që janë kryer për qëllime të biznesit të selisë së përhershme, përfshirë shpenzimet e përgjithshme administrative dhe ekzekutive të kryera për këtë qëllim, si në shtetin ku ndodhet selia e përhershme, ashtu edhe gjetkë.

5. Kur në një Shtet Kontraktues përcaktimi i fitimeve, që do t'i atribuohen një selie të përhershme, zakonisht bëhet në bazë të ndarjes të fitimeve totale të sipërmarrjes ndërmjet pjesëve të veçanta të saj, dispozitat e paragrafit 2 nuk e pengojnë atë Shtet Kontraktues për përcaktimin e fitimeve që do të tatohen në bazë të një ndarjeje të tillë si mund të bëhet zakonisht; megjithatë, metoda e ndarjes së fitimeve, duhet të jetë e tillë që rezultati të jetë në përputhje me parimet që përmban ky nen.

6. Asnjë fitim nuk do t'i atribuohet një selie të përhershme vetëm për faktin se ajo thjesht blen mallra nëpërmjet kësaj selie të përhershme për sipërmarrjen.

7. Për qëllime të paragrafëve të mësipërm, fitimet që i atribuohen një selie të përhershme do të përcaktohen me të njëjtën metodë çdo vit, përderisa nuk ka arsye të drejta dhe të mjaftueshme për të vepruar ndryshe.

8. Kur fitimet përmbajnë elemente të të ardhurave që trajtohen veças në nene të tjera të kësaj Konvente, atëherë dispozitat e atyre neneve nuk do të ndikohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8

Transporti ndërkombëtar

1. Fitimet nga veprimtaria e anijeve, avionëve ose mjeteve rrugore, ose hekurudhore në trafikun ndërkombëtar do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

2. Nëse vendi i drejtimit efektiv të një sipërmarrjeje detare është në bordin e një anijeje, atëherë ai do të konsiderohet i vendosur në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet porti i qëndrimit të zakonshtëm të anijes ose, nëse nuk ka një port të tillë, në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është përdoruesi i anijes.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen gjithashtu ndaj fitimeve nga pjesëmarrja në një marrëveshje, një biznes të përbashkët ose në një agjenci transporti ndërkombëtare.

Neni 9

Sipërmarrje të lidhura

1. Kur:

a) një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një

sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe të një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe në secilin rast kushtet që janë pranuar ose që janë diktuar ndërmjet dy sipërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin ndërmjet sipërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që do të realizohej nga njëra sipërmarrje në mungesë të këtyre kushteve, por që për shkak të këtyre kushteve nuk është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj sipërmarrjeje dhe të tatohet normalisht.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një sipërmarrjeje të atij shteti – dhe i taton ato normalisht – fitime për të cilat një sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues i është nënshtruar tatimit në atë shtet tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime që do të realizoheshin nga sipërmarrja e shtetit të përmendur në fillim, nëse kushtet e vendosura ndërmjet sipërmarrjeve do të ishin ato që do të vendoseshin ndërmjet sipërmarrjeve të pavarura, atëherë Shteti tjetër Kontraktues do të bëjë rregullimin e duhur në shumën e tatimit që ka ngarkuar mbi ato fitime. Në përcaktimin e rregullimeve të tilla, do të mbahen parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, në rast nevojë, do të konsultohen me njëri-tjetrin.

Neni 10 Dividentët

1. Dividentët e paguar nga një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues, një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto dividentë mund të tatohen gjithashtu në Shtetin Kontraktues, rezidente e të cilit është shoqëria paguese e dividentëve dhe në përputhje me ligjet e atij shteti, por, nëse pronari përfitues i dividentëve është një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë:

a) 5 për qind të shumës bruto të dividentëve, nëse pronari përfitues është një shoqëri që zotëron direkt ose indirekt të paktën 25 për qind të kapitalit të kompanisë paguese të dividentëve;

b) 15 për qind të shumës bruto të dividentëve në të gjitha rastet e tjera.

Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtyre kufizimeve.

Dispozitat e këtij paragrafi nuk do të kenë efekt mbi tatimin e shoqërisë lidhur me fitimet nga të cilat janë paguar dividentët.

3. Termi “dividentë”, sikurse përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji ose të drejta të tjera që nuk janë kërkesa borxhi, pjesëmarrjen në fitime, si dhe të ardhurat e tjera, të cilat trajtohen si të ardhura nga aksionet sipas legjislacionit tatimor të shtetit, rezidente e të cilit është shoqëria që bën pagesën.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i dividentëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues, rezidente e të cilit është shoqëria paguese e dividentëve, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty dhe zotërimi, lidhur me të cilin janë paguar dividentët, është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në një rast të tillë do të zbatohen, dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, sipas rastit.

5. Kur një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues realizon fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ky shtet tjetër mund të mos zbatojë tatim mbi dividentët e paguar nga shoqëria, përveç kur këto dividentë i paguhen një rezidenti të shtetit tjetër ose kur zotërimi, lidhur me të cilin janë paguar dividentët, është efektivisht i lidhur me një seli të përhershme ose bazë fikse të vendosur në këtë shtet tjetër; subjekt i tatimit mbi fitimet e pashpërndara të shoqërisë nuk janë gjithashtu as fitimet e pashpërndara të shoqërisë, edhe sikur dividentët e paguar ose fitimet e pashpërndara konsistojnë tërësisht ose pjesërisht si fitime apo të ardhura të realizuara në këtë shtet tjetër.

Neni 11 Interesat

1. Interesat që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto interesa mund të tatohen edhe në Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e këtij shteti, por, kur pronari përfitues i interesave është një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i zbatuar nuk duhet të kalojë 5 për qind të shumës bruto të interesit. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi “interesa”, në kuptimin e përdorur në këtë nen nënkupton të ardhurat nga kërkesat e borxhit të çdo lloji, të siguruara ose jo me hipotekim dhe që e kanë ose jo të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e debitorit, dhe në veçanti, të ardhurat nga obligacionet shtetërore, bonot e thesarit dhe lloje të tjera letrash me vlerë, përfshirë edhe fitimet apo shpërblimet që rrjedhin nga këto obligacione ose bono thesari. Gjjobat e ngarkuara për pagesa të vonuara nuk do të konsiderohen si interesa për qëllime të këtij neni.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen në qoftë se pronari përfitues i interesave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin lindin interesat, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty ose kryen në këtë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty dhe kërkesa e huasë për të cilën paguhet interesi është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose 14, sipas rastit.

5. Interesat do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur paguesi është një rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan interesat, qoftë ose jo rezident i njërit Shtet Kontraktues, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilin ka lindur huaja për të cilën paguhet interesi dhe këto interesa krijohen nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto interesa do të konsiderohen se janë krijuar në shtetin ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur, për shkak të marrëdhënieve të veçanta ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues të interesave ose ndërmjet të dyve dhe personave të tretë, shuma e interesave, bazuar në huanë për të cilën paguhet, e kalon shumën mbi të cilën duhej të ishte rënë dakord ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën normale do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

Neni 12 **Honoraret**

1. Honoraret që lindin në një Shtet Kontraktues dhe i paguhet një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto honorare mund të tatohen gjithashtu në Shtetin Kontraktues ku krijohen dhe në përputhje me ligjet e atij shteti, por, nëse pronari përfitues i honorareve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i ngarkuar nuk duhet të kalojë 5 për qind të shumës bruto të honorareve. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e aplikimit të këtij kufizimi.

3. Në funksion të këtij neni, termi “honorare” nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejte të autorit për punimet letrare, artistike ose punë shkencore, përfshirë filmat kinematografikë dhe filmat apo kasetat për transmetime radiotelevizive, çdo patentë, markë tregtare, skicë ose model, plan, proces ose formulë sekrete apo për informacione lidhur me eksperiencën industriale, tregtare ose shkencore. Pagesat e bëra për asistencë teknike apo shërbime teknike nuk do të konsiderohen si pagesa për informacion industrial, tregtar apo eksperiencë shkencore, por do të tatohen në zbatim të dispozitave të nenit 7, nenit 14, sipas rastit.

4. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i honorareve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen honoraret, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe e drejta ose prona lidhur me të cilën paguhet honoraret është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, sipas rastit.

5. Honoraret do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur pagues është një

rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan honoraret, qoftë ose jo rezident i një Shteti Kontraktues, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur e drejta e pagimit të honorareve dhe këto honorare kanë lindur nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto honorare konsiderohen se kanë lindur në Shtetin Kontraktues ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur, për shkak të lidhjeve të veçanta ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe personave të tretë, shuma e honorareve, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin ato janë paguar, e kalon shumën për të cilën do të ishte rënë dakord ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, atëherë dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në një rast të tillë shuma e shpërblimit që kalon shpërblimin normal do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve përkatëse të secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

Neni 13

Fitimet nga kapitali

1. Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme që i referohen nenit 6 dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme që bëjnë pjesë në pasurinë biznesore të një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose i pasurive të luajtshme që i përkasin një baze fikse që një rezident i një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues për të kryer shërbime personale të pavarura, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i vetë selisë së përhershme (vetëm ose bashkë me sipërmarrjen) ose i bazës fikse, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

3. Fitimet e realizuara nga tjetërsimi i anijeve, avionëve ose mjeteve të transportit rrugor, që veprojnë në trafikun ndërkombëtar ose i pasurive të luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre mjeteve të transportit do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin, fitimi i sipërmarrjes është i tatueshëm në zbatim të nenit 8 të kësaj Konvente.

4. Fitimet nga tjetërsimi i aksioneve të një kompanie, pasuria e së cilës konsiston direkt ose indirekt kryesisht si pasuri e paluajtshme e ndodhur në një Shtet Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet, por vetëm për pjesën e fitimit që lidhet me pasurinë e paluajtshme të vendosur në këtë shtet.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie që nuk mbulohet nga paragrafët e mësipërm të këtij neni, do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është tjetërsuesi.

Neni 14

Shërbimet personale të pavarura

Të ardhurat e realizuara nga një individ, i cili është rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me shërbimet profesionale ose shërbime të tjera të ngjashme të një karakteri të pavarur do të tatohen vetëm në atë shtet, përveç në rrethanat që vijojnë, ku këto të ardhura mund të tatohen gjithashtu në Shtetin tjetër Kontraktues:

a) nëse ai ka një bazë fikse në Shtetin tjetër Kontraktues që rregullisht i shërben atij për kryerjen e aktiviteteve të tij; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet asaj baze fikse mund të tatohet në atë shtet tjetër;

b) nëse qëndrimi i tij në Shtetin tjetër Kontraktues është për një periudhë ose periudha që në total arrijnë, ose kalojnë 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin përkatës kalendarik; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave të realizuara nga aktivitetet e tij të ushtruara në atë shtet tjetër mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin në veçanti aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore ose të mësimdhënies, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, dentistëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve dhe llogaritarëve.

Neni 15

Shërbimet personale të varura

1. Pa cenuar dispozitat e neneve 16, 18 dhe 19, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga punësimi i tij do të tatohen vetëm në atë shtet, përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna ushtrohet në këtë mënyrë, atëherë këto të ardhura mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimet e përfituara nga një rezident i një Shteti Kontraktues, lidhur me punën e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues, do të tatohen vetëm në shtetin e përmendur në fillim, nëse të gjitha kushtet e mëposhtme plotësohen:

a) përfituesi është prezent në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që në total nuk i kalon 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës;

b) shpërblimi paguhet nga, ose në emër të një punëdhënësi që nuk është rezident i shtetit tjetër;

c) shpërblimi nuk ka lindur nga një seli e përhershme ose bazë fikse që punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, pagesat e kryera lidhur me punën e ushtruar në bordin e një anijeje, avioni ose mjeti rrugor ose hekurudhor që operohet në trafikun ndërkombëtar, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues në të cilin fitimi i sipërmarrjes tatohet në zbatim të nenit 8 të kësaj Konvente.

Neni 16

Shpërblimet e drejtorëve

1. Shpërblimet e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në pozitën e tij si anëtar i bordit të drejtorëve ose çdo organi të ngjashëm të një shoqërie, që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

Paragrafi i mësipërm do të zbatohet gjithashtu mbi pagesat e bëra në lidhje me ushtrimin e funksioneve të cilat, sipas ligjit të Shtetit Kontraktues, rezidente e së cilës kompania është, janë funksione që konsiderohen me natyrë të ngjashme me ato të ushtruara nga persona të referuar në dispozitën e mësipërme.

2. Shpërblimet e realizuara nga një individ:

a) i cili është rezident i një Shteti Kontraktues referuar paragrafit 1, nga një kompani e cila është rezidente e një Shteti Kontraktues në lidhje me ushtrimin e funksioneve ditore të vazhueshme të një natyre menaxheriale apo teknike;

b) i cili është ortak në një ortakëri që është rezidente në një Shtet Kontraktues në lidhje me ushtrimin e funksioneve ekzekutive ditore për këtë ortakëri, do të tatohen në përputhje me dispozitat e nenit 15.

Neni 17

Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues si një artist teatri, kinematografie, radiotelevizioni, muzikant apo një sportist nga aktivitetet e tij personale si të tilla të ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat lidhur me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist ose sportist në pozitën e tij si i tillë realizohen jo direkt nga vetë artisti ose sportisti, por nga një person tjetër, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues në të cilin janë ushtruar aktivitetet e artistit ose sportistit.

Neni 18

Pensionet

Pa cenuar dispozitat e paragrafit të nenit 19, pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme që i paguhet për punësimin në të kaluarën një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë shtet.

Neni 19
Shërbimet qeveritare

1. a) Pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, të ndryshme nga pensionet, të paguara nga një Shtet Kontraktues, nënndarje politike ose nga një autoritet lokal atje, një individ, lidhur me shërbimet e kryera atij shteti, nënndarje ose autoriteti, do të tatohen vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto pagesa dhe shpërblime të ngjashme do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse shërbimet janë kryer në atë shtet dhe individ është rezident i atij shteti, i cili (individ):

i) është nënshkruar në këtë shtet;

ii) nuk bëhet rezident i këtij shteti vetëm për qëllimin e kryerjes së këtij shërbimi.

2. a) Çdo person i paguar nga, ose prej fondeve të krijuara nga një shtet Kontraktues, nënndarje politike ose autoritet lokal atje, një individ, lidhur me shërbimet e kryera ndaj atij shteti, nënndarje politike ose autoriteti lokal, do të tatohen vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto pensione do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse individ është rezident dhe nënshkruar në atë shtet tjetër.

3. Dispozitat e nenëve 15, 16, 17 dhe 18 do të zbatohen ndaj shpërblimeve dhe ndaj pensione, lidhur me shërbimet e kryera në lidhje me një biznes të ushtruar nga një Shtet Kontraktues, nënndarje politike apo një autoritet lokal atje.

Neni 20
Studentët dhe specialistët

Kur një student ose specialist që është ose ishte menjëherë para ardhjes në një Shtet Kontraktues rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që është prezent në shtetin e përmendur në fillim vetëm për qëllim të arsimit ose specializimit të tij, për çdo pagesë të marrë nga ky student për qëllim të mbajtjes së tij, arsimit ose specializimit nuk do të tatohet në atë shtet, me kusht që të tilla pagesa lindin nga burime jashtë atij shteti.

Neni 21
Të ardhura të tjera

1. Lloje të ardhurash të përfituara nga një rezident i një Shteti Kontraktues, kudo që të lindin, që nuk lidhen me nenet e mësipërme të kësaj Konvente, do të tatohen vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave, që nuk janë të ardhura nga pasuria e paluajtshme të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 6, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe e drejta ose pasuria lidhur me të cilën paguhet shpërblimi është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, sipas rastit.

3. Pavarësisht nga sa parashikohet në paragrafët 1 dhe 2, të ardhurat e tjera të një rezidenti të një Shteti Kontraktues që nuk lidhen me nenet e mësipërme të kësaj Konvente dhe lindin në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen gjithashtu në këtë shtet tjetër, nëse këto të ardhura të tjera nuk janë tatuar në shtetin e përmendur në fillim.

Neni 22
Kapitali

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të paluajtshme të referuara në nenin 6, të zotëruara nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të luajtshme që bëjnë pjesë në pasurinë e biznesit të një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga pasuri të luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti

Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, mund të taten në këtë shtet tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anije, avion dhe mjete rrugore ose hekurudhore që operojnë në trafikun ndërkombëtar dhe nga pasuritë e luajtshme që i përkasin aktivitetit të këtyre mjeteve të transportit, do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të taten vetëm në atë shtet.

Neni 23

Eliminimi i tatimit të dyfishtë

Tatimi i dyfishtë do të eliminohet në mënyrën që vijon:

1. Në Shqipëri:

a) Kur një rezident i Shqipërisë realizon të ardhura ose zotëron kapitale të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente mund të taten në Belgjikë, Shqipëria do të lejojë:

i) një reduktim nga tatimi i saj mbi të ardhurat e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguara në Belgjikë;

ii) një reduktim nga tatimi shqiptar mbi kapitalin e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguara në Belgjikë.

Megjithatë, ky reduktim në çdo rast, nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat ose kapitalin e llogaritur para dhënies së reduktimit që i atribuohet, sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit që mund të taten në Belgjikë.

b) Kur në përputhje me dispozitat e Konventës, të ardhurat e realizuara ose kapitali i zotëruar nga një rezident i Shqipërisë përjashtohet nga tatimi në Shqipëri, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin e mbetur të këtij rezidenti, Shqipëria merr parasysh të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

2. Në Belgjikë:

a) Kur një rezident i Belgjikës realizon të ardhura ose zotëron elemente kapitali të cilat janë tatuar në Shqipëri, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, të ndryshme nga ato të paragrafit 2 të nenit 10, të paragrafëve 2 dhe 6 të nenit 11 dhe të paragrafëve 2 dhe 6 të nenit 12, Belgjika do të përjashtojë nga tatimi këto të ardhura apo elemente të kapitalit, por mundet që, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat apo kapitalin e mbetur të këtij rezidenti, të aplikojë shkallën tatimore, e cila mund të aplikohet mbi këto të ardhura ose elemente të kapitalit, të cilat nuk janë përjashtuar.

b) Sipas dispozitave të legjislacionit belg në lidhje me reduktimin nga tatimi belg i tatimeve të paguara jashtë Belgjikës, kur një rezident i Belgjikës siguron pjesë (zëra) të të ardhurave të tij të përgjithshme (në shkallë botërore) për qëllime tatimore belge, të cilat janë dividendë që nuk përjashtohen nga tatimi belg në përputhje me dispozitat e nënparagrafit c) në vijim, lidhur me interesat ose honoraret, tatimi shqiptar i mbajtur për të ardhura të tilla do të njihet si kreditim ndaj tatimit belg për këto të ardhura.

c) Dividentët e realizuar nga një kompani, e cila është rezidente e Belgjikës nga një kompani e cila është rezidente e Shqipërisë, do të përjashtohen nga tatimi korporativ në Belgjikë sipas kushteve dhe brenda kufizimeve të dhëna në ligjin belg.

3. Për qëllime të paragrafit 2 të këtij neni, tatimi mbi të ardhurat i paguar në Shqipëri nga një rezident i Belgjikës në lidhje me fitimet nga biznesi (neni 7) do të përfshijë çdo shumë që do të ishte paguar si tatim shqiptar, por që është përjashtuar ose reduktuar në bazë të dispozitave të ligjit 7677, datë 3 mars 1993 "Për tatimin mbi fitimin", për aq kohë sa ai ligj nuk është ndryshuar nga data e nënshkrimit të kësaj Konvente ose është modifikuar vetëm për aspekte të parëndësishme, apo ndonjë dispozitë tjetër me një karakter esencialisht të ngjashëm që mund të ketë hyrë në fuqi më vonë, për të cilat është rënë dakord nga autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, nëse nuk është modifikuar më pas ose është modifikuar në aspekte të parëndësishme. Dispozitat e këtij paragrafi do të aplikohen vetëm nëse fitimet nga biznese të tilla janë realizuar nga aktivitete tregtare apo prodhues, shitje mallrash ose shërbimesh të kryera brenda Shqipërisë dhe që nuk rezultojnë nga shërbime financiare, përveç kur autoritetet kompetente bien dakord që aktivitetet e përgjithshme që realizojnë këto të ardhura janë për të mirën e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë. Dispozitat e këtij paragrafi aplikohen

vetëm për pesë vitet e para, gjatë të cilës kjo Konventë është në zbatim. Kjo periudhë mund të shtyhet me një marrëveshje ndërmjet autoriteteve kompetente.

Neni 24 **Mosdiskriminimi**

1. Nënshetësit e një Shteti Kontraktues nuk do të jenë në Shtetin tjetër Kontraktues subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë më i rëndësishëm sesa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave mund ose i nënshtrohen nënshetësit e këtij shteti tjetër në rrethana të njëjta, në veçanti në lidhje me rezidencën. Kjo dispozitë, pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, do të zbatohet gjithashtu ndaj personave që nuk janë rezidentë të njërit apo të asnjërit prej Shteteve Kontraktuese.

2. Tatimi i një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka një Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të jetë më pak i favorshëm në këtë shtet tjetër, sesa tatimi i vjelur ndaj sipërmarrjeve ose rezidentëve të këtij shteti tjetër që ushtrojnë aktivitete të njëjta. Kjo dispozitë nuk do të merret si detyrim i njërit Shtet Kontraktues për t'i garantuar rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues lehtësime personale apo reduktime për qëllime tatimore nga ato që i garanton rezidentëve të vet për gjendjen civile dhe përgjegjësitë familjare që ata kanë.

3. Përfshijë rastet kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, paragrafit 6 të nenit 11 ose paragrafit 6 të nenit 12 interesat, honoraret dhe shpërblime të tjera të paguara nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj sipërmarrjeje, do të jenë të reduktueshme nën të njëjtat kushte njëlloj sikur ato t'i paguheshin një rezidenti të shtetit të përmendur në fillim. Në mënyrë të ngjashme, çdo borxh i një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj sipërmarrjeje, do të jetë i reduktueshëm nën të njëjtat kushte njëlloj sikur ajo të kishte kontraktuar me një rezident të shtetit të përmendur në fillim.

4. Sipërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është totalisht ose pjesërisht i zotëruar apo kontrolluar, direkt ose indirekt, nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do të jenë në shtetin e përmendur në fillim subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë më i rëndësishëm sesa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen apo mund t'i nënshtrohen, sipërmarrje të tjera të ngjashme të shtetit të përmendur në fillim.

5. Dispozitat e këtij neni, pavarësisht nga dispozitat e nenit 2, do të zbatohen ndaj tatimeve të çdo lloji dhe përshkrimi. Sidoqoftë, ky paragraf nuk do të aplikohet në lidhje me tatimet që aplikohen ndaj kryerjes së shërbimeve.

Neni 25 **Procedura e mirëkuptimit reciprok**

1. Kur një person mendon se veprimet e njërit ose të dy Shteteve Kontraktuese e rëndojnë apo do ta rëndojnë atë me tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, pavarësisht nga mënyrat e ankimit të parashikuara në legjislacionin e brendshëm të këtyre shteteve, ai mund t'u paraqesë rastin e tij autoriteteve kompetente të Shtetit Kontraktues, rezidenti i të cilit ai është ose, nëse çështja e tij ka të bëjë me paragrafin 1 të nenit 24, ai mund t'u paraqesë atë Shtetit Kontraktues, nënshetësi i të cilit ai është. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë lidhur me veprimin që ka rezultuar në tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e Konventës.

2. Autoriteti kompetent, nëse kërkesa i duket e justifikuar dhe ai vetë nuk e ka të mundur arritjen e një zgjidhje të kënaqshme, do të përpiqet ta zgjidhë çështjen me mirëkuptim reciprok me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me Konventën. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht nga limitet kohore të përcaktuara nga ligjet e brendshme të Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen që me mirëkuptim reciprok të zgjidhin çdo vështirësi ose dyshim që lind nga interpretimi ose zbatimi i Konventës.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të bien dakord mbi procedurat e nevojshme administrative për zbatimin e parashikimeve të Konventës dhe në veçanti mbi provat të cilat duhet të jepen nga rezidentët e secilit Shtet Kontraktues, me qëllim përfitimin në shtetin tjetër të përfshijëmeve ose reduktimeve tatimore të parashikuara nga Konventa.

5. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin direkt me qëllim arritjen e mirëkuptimit në kuptimin e paragrafëve të mësipërm të këtij neni.

Neni 26

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacione të nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente ose të ligjeve të brendshme të Shteteve Kontraktuese lidhur me tatimet që mbulon Konventa, përderisa ato tatime nuk janë në kundërshtim me Konventën. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga neni 1. Çdo informacion i marrë nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si sekret, në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë nën legjislacionin e brendshëm të atij shteti dhe do t'u serviret vetëm personave ose autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) të përfshira në llogaritjen ose mbledhjen e tatimeve, me imponimin ose ndjekjet lidhur me shkeljet tatimore ose lidhur me ankesat ndaj tatimeve që mbulon Konventa. Këta persona ose autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për të tilla qëllime. Ata mund ta servirin informacionin në procedurat ose vendimet gjyqësore.

2. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 1 nuk do të interpretohen në kuptimin që i imponojnë njërit prej Shteteve Kontraktues detyrimin:

a) të zbatojë masa administrative në ndryshim me ligjet dhe praktikat administrative të atij shteti ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) të japë informacione që ndalohen sipas ligjeve dhe praktikës normale administrative të atij shteti ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) të japë informacione që mund të nxirrnin një sekret tregtar, biznesi, industrial, komercial ose sekret profesional apo proces tregtar, ose informacione, komunikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

3. Për qëllime të këtij neni, Konventa do të zbatohet pavarësisht nga dispozitat e nenit 2, (tatimet që mbulon Konventa) ndaj tatimeve të çdo lloji të vendosura nga një Shtet Kontraktues.

Neni 27

Asistenca në mbledhjen e tatimeve

1. Shtetet Kontraktuese do t'i ofrojnë ndihmë dhe asistencë njëri-tjetrit me qëllim informimi dhe mbledhjen e tatimeve së bashku me mbipagesat shtesat, interesat, koston dhe gjobat në lidhje me këto tatime.

2. Me kërkesë të autoritetit kompetent të një Shteti Kontraktues, autoriteti kompetent i Shtetit tjetër Kontraktues, në bazë të dispozitave ligjore dhe rregullave që aplikohen për informacionin dhe mbledhjen e tatimeve në fjalë të shtetit të fundit, do të sigurojë informacionin dhe mbledhjen e tatimeve të përmendura në paragrafin 1, siç kërkohet në shtetin e përmendur në fillim. Kjo kërkesë nuk do të ketë ndonjë prioritet në shtetin ku është bërë kërkesa.

3. Kërkesat e paraqitura në paragrafin 2 do të mbështeten nga një kopje zyrtare e instrumentit që lejon ekzekutimin, shoqëruar, aty kur duhet, nga një kopje e vendimit administrativ ose gjyqësor përfundimtar.

4. Në lidhje me kërkesat që janë të hapura për apelim, autoriteti kompetent i një Shteti Kontraktues, mund t'i bëjë kërkesë autoritetit kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me qëllim mbrojtjen e të drejtave, të marrë masa mbrojtëse që parashikohen në legjislacionin e shtetit tjetër. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen me ndryshimet e duhura për këto masa.

5. Dispozitat e këtij neni, pavarësisht nga dispozitat e nenit 2, do të zbatohen ndaj tatimeve të çdo lloji të vendosura në emër apo nga një Shtet Kontraktues.

6. Dispozitat e paragrafit 1 të nenit 26, gjithashtu do të zbatohen ndaj çdo lloji informacioni, i cili, nisur nga kuptimi i këtij neni, i është dhënë autoritetit kompetent të një Shteti Kontraktues.

7. Asnjë dispozitë në këtë nen nuk mund të detyrojë Shtetet Kontraktuese për aplikimin e masave apo mjeteve shtrënguese të një natyre të ndryshme nga ato që përdoren në mbledhjen e tatimeve të veta në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e tyre.

Neni 28
Funksionarët diplomatikë dhe konsullorë

Dispozitat e kësaj Konvente nuk cenojnë privilegjet fiskale të funksionarëve diplomatikë dhe konsullorë që rrjedhin nga rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare apo nga dispozita të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 29
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të ratifikohet dhe Shtetet Kontraktuese do të njoftojnë njëri-tjetrin për kompletimin e procedurave të kërkuara lidhur me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente.

2. Konventa do të hyjë në fuqi ditën e njoftimit të mëvonshëm referuar në paragrafin 1 dhe dispozitat e Konventës do të kenë efekt:

a) Në Shqipëri lidhur me të ardhurat e realizuara ose kapitalin e zotëruar, më ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik që ndjek atë të hyrjes në fuqi të Konventës.

b) Në Belgjikë:

i) lidhur me tatimet mbi të ardhurat në burim, për të ardhurat e kredituara apo të pagueshme më, ose pas ditës së parë të janarit të vitit që pason vitin në të cilin Konventa hyn në fuqi;

ii) lidhur me tatime të tjera të vendosura mbi të ardhurat në periudha tatimore që fillojnë më, ose pas ditës së parë të janarit të vitit që pason vitin në të cilin Konventa hyn në fuqi;

iii) lidhur me tatimin mbi kapitalin ose çdo element të kapitalit që ekziston më, ose pas 1 janarit të çdo viti i cili vjen pas vitit në të cilin Konventa hyn në fuqi.

Për qëllimet e nenit 26 (shkëmbimi i informacionit), dispozitat e këtij neni do të kenë efekt më, ose pas datës në të cilën Konventa hyn në fuqi.

Neni 30
Përfundimi

Kjo Konventë do të mbetet në fuqi deri në përfundimin nga njëri Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund të përfundojë Konventën duke i dhënë Shtetit tjetër Kontraktues njoftimin me shkrim të përfundimit, nëpërmjet kanaleve diplomatike, të paktën gjashtë muaj përpara përfundimit të çdo viti kalendarik që pason periudhën prej pesë vitesh nga data e hyrjes në fuqi të Konventës. Në një rast të tillë Konventa do të pushojë së pasuri efekt:

a) Në Shqipëri lidhur me të ardhurat e realizuara ose kapitalin e zotëruar më, ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik që ndjek vitin në të cilin është dhënë njoftimi i përfundimit.

b) Në Belgjikë:

i) lidhur me tatimet mbi të ardhurat e mbajtura në burim, mbi të ardhurat e kreditueshme apo të pagueshme më, ose pas ditës së parë të janarit të vitit që ndjek vitin në të cilin është dhënë njoftimi i përfundimit;

ii) lidhur me tatimet e tjera mbi të ardhurat në periudha tatimore që fillojnë më, ose pas ditës së parë të janarit të vitit në të cilin është dhënë njoftimi i përfundimit;

iii) lidhur me tatimet mbi kapitalin ose elemente të kapitalit që ekzistojnë më, ose pas ditës së parë të janarit të vitit që ndjek vitin në të cilin është dhënë njoftimi i përfundimit.

Bërë në Bruksel, më 14 nëntor 2002 në dy kopje, në gjuhën angleze.

L I G J
Nr.9052 datë 17.4.2003

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “PROTOKOLLIN SHITESË TË
“KONVENTËS PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ
GRUAS””**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Protokollin shtesë të “Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3795, datë 24.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

REZOLUTË

**E ADAPTUAR NGA ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME
[PA REFERENCË TEK KOMITETI KRYESOR (A/54/L.4)]**

54/4. PROTOKOLLI SHITESË I KONVENTËS PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE

Asambleja e përgjithshme:

duke riafirmuar Deklaratën e Vienës dhe Programin për veprim dhe Deklaratën e Pekinit dhe Platformën për veprim;

duke kujtuar që Platforma e Pekinit për veprim, të bindur që Deklarata e Vienës dhe Programi për veprim, mbështesin procesin e inicuar nga Komisioni për statusin e grave, me qëllim për të përpunuar një draft të protokollit shtesë të Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër gruas, i cili mund të hyjë në fuqi sa më shpejt të jetë e mundur me të drejtën e një procedure kërkimi;

duke vërejtur që Platforma e Pekinit për veprim gjithashtu u bën thirrje të gjitha shteteve që nuk e kanë ratifikuar ende Konventën ose pranojnë që ta bëjnë sa më shpejt të jetë e mundur, në mënyrë që ratifikimi universal i Konventës të arrihet deri në vitin 2000,

1. Adapton dhe hap për nënshkrim, ratifikim dhe pranim protokollin shtesë të Konventës, tekst i cili gjendet në aneksin bashkëngjitur kësaj rezolute.

2. U bën thirrje të gjitha shteteve që e kanë nënshkruar, ratifikuar ose pranuar Konventën, të nënshkruajnë, ratifikojnë ose të pranojnë protokollin sa më shpejt të jetë e mundur.

3. Thekson që Shtetet Palë në protokoll duhet të angazhohen për respektimin e të drejtave dhe procedurave të parashikuara në protokoll dhe të bashkëpunojnë me Komitetin për eliminimin e diskriminimit kundër grave në të gjitha nivelet e veprimit të tij sipas protokollit.

4. Thekson gjithashtu që Komiteti duhet të vazhdojë të udhëhiqet nga parimet e mospërzgjedhjes, paanësisë dhe objektivitetit për përmbushjen e mandatit dhe funksioneve të tij sipas protokollit.

5. I kërkon Komitetit të organizojë mbledhje për ushtrimin e funksioneve sipas protokollit pas hyrjes në fuqi të tij, në vazhdim të mbledhjeve të bëra sipas nenit 20 të Konventës; kohëzgjatja e mbledhjeve të tilla duhet të përcaktohet dhe, në qoftë se është e nevojshme, të rishikohet në një mbledhje të Shteteve Palë për protokollin, objekt për aprovim nga Asambleja e Përgjithshme.

6. I kërkon Sekretariatit të Përgjithshëm të sigurojë staf dhe lehtësirat e nevojshme për realizimin efektiv të funksioneve të Komitetit sipas protokollit pas hyrjes në fuqi të tij.

7. Gjithashtu i kërkon Sekretariatit të Përgjithshëm të përfshijë informacion për statusin e protokollit në raporte të rregullta të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme për statusin e Konventës. Mbledhja plenare e 28-të, 6 tetor 1999

ANEKS

PROTOKOLLI

SHTESË I KONVENTËS PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE

Shtetet Palë në këtë protokoll:

duke vërejtur se Karta e Kombeve të Bashkuara ripohon besimin në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerat e personit dhe në barazinë e të drejtave midis grave dhe burrave;

duke vërejtur se Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut shpall se të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe të drejta dhe gjithsecili gëzon të drejtat dhe liritë e parashtruara aty, pa asnjë lloj dallimi, duke përfshirë edhe dallim në bazë seksi;

duke kujtuar se Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe dokumentet e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ndalojnë diskriminimin mbi bazë seksi;

duke kujtuar gjithashtu Konventën mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (Konventa), ku Shtetet Palë dënojnë diskriminimin ndaj grave në të gjitha format e tij dhe janë marrë vesh të ndjekin me të gjitha mënyrat dhe pa vonesë një politikë për eliminimin e diskriminimit ndaj grave;

duke rikonfirmuar vendosmërinë e tyre për t'u siguruar grave gëzimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe të ndërmarrin masa efektive për parandalimin e dhunimit të këtyre të drejtave dhe lirive,

vendosën si vijon:

Neni 1

Një Shtet Palë në këtë protokoll ("Shtet Palë") i njeh të drejtën Komitetit për eliminimin e diskriminimit ndaj grave ("Komiteti") të presë dhe të marrë në konsideratë komunikimet e paraqitura në përputhje me nenin 2.

Neni 2

Komunikimet mund të paraqiten nga individë ose në emër të individëve ose grupeve të individëve, nën juridiksionin e një Shteti Palë, që pretendojnë të jenë viktimat të dhunimit të ndonjë prej të drejtave të vendosura në Konventë, prej Shtetit Palë. Kur paraqitet një komunikim në emër të individëve ose të një grupi individësh, kjo do të bëhet me miratimin e tyre, përndryshe autori duhet të justifikojë veprimin në emër të tyre pa këtë miratim.

Neni 3

Komunikimet do të paraqiten me shkrim dhe nuk do të jenë anonime. Asnjë komunikim nuk do të merret nga Komiteti, nëse ai i përket një Shteti Palë të Konventës që nuk është Palë në këtë protokoll.

Neni 4

1. Komiteti nuk do të marrë në konsideratë një komunikim po të mos vërtetohet se janë përdorur të gjitha masat e brendshme të mundshme, por zbatimi i këtyre masave është zgjedhur pa arsye ose në rast se ato nuk sjellin një ndihmesë efektive.

2. Komiteti do ta deklarojë një komunikim të papranueshëm kur:

a) e njëjta çështje është shqyrtuar nga Komiteti ose ka qenë, ose është duke u shqyrtuar, ose është duke u shqyrtuar sipas një procedure tjetër marrëveshjeje ose studimi ndërkombëtar;

- b) është i papajtueshëm me dispozitat e Konventës;
- c) është qartësisht i pabazuar ose jo i mbështetur mjaftueshëm në prova;
- d) është një abuzim i së drejtës për të paraqitur një komunikim;
- e) faktet, që janë çështje të komunikimit, kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij protokollit për Shtetin Palë përkatës ose nëqoftëse këto fakte nuk kanë ndodhur pas kësaj date.

Neni 5

1. Në çdo kohë pas marrjes së komunikimit dhe para një vendimi mbi vlerat e arritura, Komiteti mund t'i transmetojë Shtetit Palë përkatës marrjen nën shqyrtim urgjentisht të një kërkesë në të cilën Shteti Palë merr masa të tilla të përkohshme sipas nevojës, për të shmangur dëme të mundshme të pariparueshme ndaj viktimës ose viktimave nga dhunimi i deklaruar.

2. Kur Komiteti ushtron lirinë e tij të veprimit sipas paragrafit 1, kjo nuk nënkupton një vendim mbi pranueshmërinë ose mbi vlerat e komunikimit.

Neni 6

1. Nëse Komiteti e konsideron një komunikim të papranueshëm duke mos iu referuar Shtetit Palë përkatës dhe është siguruar miratimi i individit ose individëve për njohjen e identitetit të tyre nga Shteti Palë, Komiteti do t'i sjellë një komunikim paraqitur atij nën këtë protokoll në mënyrë konfidenciale për vëmendjen e Shtetit Palë përkatës.

2. Brenda gjashtë muajve, Shteti Palë marrës duhet t'i paraqesë Komitetit shpjegime me shkrim ose deklarata që qartësojnë çështjen dhe masën, nëse është ndërmarrë një e tillë nga Shteti Palë.

Neni 7

1. Komiteti do t'i marrë në konsideratë komunikimet e paraqitura nën këtë protokoll nën dritën e të gjithë informacionit që i është dhënë atij nga, ose në emër të individëve apo grupeve të individëve dhe nga Shteti Palë përkatës, duke u siguruar që ky informacion u është transmetuar palëve përkatëse.

2. Komiteti do të zhvillojë mbledhje të mbyllura ku do të shqyrtojë komunikimet nën këtë Protokoll.

3. Pas shqyrtimit të një komunikimi, Komiteti do t'u transmetojë pikësyzimet e tij mbi komunikimin, së bashku me rekomandimet e tij, nëse ka, palëve përkatëse.

4. Shteti Palë do të japë konsideratën përkatëse për pikësyzimet e Komitetit, së bashku me rekomandimet e tij, nëse ka, dhe do t'i paraqesë Komitetit, brenda gjashtë muajve, një përgjigje me shkrim, ku të përfshihet informacioni mbi veprimet e ndërmarra nën dritën e pikësyzimeve dhe rekomandimeve të Komitetit.

5. Komiteti mund të ftojë Shtetin Palë të paraqesë informacion të mëtejshëm rreth ndonjë mase që Shteti Palë ka marrë në përgjigje të pikësyzimeve ose rekomandimeve të tij, nëse ka pasur të tilla, duke përfshirë gjykimin si të përshtatshëm nga Komiteti, në raportet vijuese të Shtetit Palë nën nenin 18 të Konventës.

Neni 8

1. Nëse Komiteti merr informacion të sigurt, në të cilin tregohet për dhunime serioze ose sistematike nga një Shtet Palë të të drejtave të parashtruara në Konventë, Komiteti duhet të ftojë Shtetin Palë të bashkëpunojë për shqyrtimin e informacionit dhe në fund të paraqesë vërejtjet në lidhje me informacionin përkatës.

2. Duke vlerësuar vërejtjet që ka paraqitur Shteti Palë përkatës sikurse edhe ndonjë informacion tjetër të sigurt dhënë atij, Komiteti mund të caktojë një ose disa prej anëtarëve të tij të drejtojnë një hetim dhe t'i raportojë urgjentisht Komitetit. Kur autorizohet dhe me miratimin e Shtetit Palë, nën hetim, mund të përfshihet edhe një vizitë në territorin e tij.

3. Pas shqyrtimit të përfundimeve të këtij hetimi, Komiteti ia transmeton këto përfundime

Shtetit Palë përkatës së bashku me ndonjë koment dhe rekomandim.

4. Shteti Palë përkatës, brenda gjashtë muajve të marrjes së përfundimeve, komenteve dhe rekomandimeve të transmetuara nga Komiteti, duhet t'i paraqesë vërejtjet e tij Komitetit.

5. Një hetim i tillë do të drejtohet në mënyrë konfidenciale dhe do të kërkohe bashkëpunimi me Shtetin Palë në të gjitha etapat e procedurës.

Neni 9

1. Komiteti mund të ftojë Shtetin Palë përkatës të përfshijë në raport sipas nenit 18 të Konventës, detaje të ndonjë mase të marrë në përgjigje të hetimit të drejtuar sipas nenit 8 të këtij protokoll.

2. Komiteti mund, nëse është e nevojshme, pas përfundimit të periudhës prej gjashtë muajsh referuar nenit 8.4, të ftojë Shtetin Palë përkatës ta informojë atë për masat e marra në përgjigje të një hetimi të tillë.

Neni 10

1. Çdo Shtet Palë mund, në momentin e firmosjes së ratifikimit të këtij protokoll ose të hyrjes në fuqi të tij, të deklarojë se ai nuk e njeh kompetencën që i sigurojnë Komitetit nenet 8 dhe 9.

2. Çdo Shtet Palë që ka bërë një deklaratë në lidhje me paragrafin 1 të këtij neni mund, në çdo kohë, ta tërheqë këtë deklaratë duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm.

Neni 11

Një Shtet Palë do të marrë të gjitha hapat e duhura për t'u siguruar që individët nën këtë juridiksion nuk janë subjekt i një keqtrajtimi ose kërcënimi si rrjedhojë e komunikimit me Komitetin në vijim të këtij protokoll.

Neni 12

Komiteti do të përfshijë në raportin e tij vjetor sipas nenit 21 të Konventës një përmbledhje të aktivitetit nën këtë protokoll.

Neni 13

Çdo Shtet Palë merr përsipër të bëjë të njohur gjerësisht dhe të publikojë Konventën dhe këtë protokoll dhe të lehtësojë hyrjen e informacionit rreth pikëpamjeve dhe rekomandimeve të Komitetit, në veçanti, mbi çështjet ku përfshihet Shteti Palë.

Neni 14

Komiteti do të zhvillojë rregullat e tij të procedurës që do të ndiqen gjatë ushtrimit të funksioneve të dhëna atij nga ky protokoll.

Neni 15

1. Ky protokoll do të jetë i hapur për firmë për çdo shtet që ka nënshkruar, ratifikuar ose miratuar në Konventë.

2. Ky protokoll do të jetë subjekt i ratifikimit nga ndonjë shtet që ka ratifikuar ose miratuar Konventën. Dokumentet e ratifikimit do të depozitohen në Sekretarinë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

3. Ky protokoll do të jetë i hapur për hyrjen e ndonjë shteti që ka ratifikuar ose miratuar Konventën.

4. Hyrja do të bëhet nëpërmjet depozitimit të dokumentit të hyrjes pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 16

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të dhjetë dokumenteve të ratifikimit ose miratimit tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

2. Për çdo shtet që ratifikon këtë protokoll ose e miraton atë pas hyrjes së tij në fuqi, ky protokoll do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të dokumentit të tij të ratifikimit ose miratimit.

Neni 17

Në këtë protokoll nuk lejohen rezervime.

Neni 18

1. Ndonjë Shtet Palë mund t'i propozojë këtij protokoll një amendament dhe t'ia dërgojë atë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm më pas do t'ua komunikojë amendamentet e propozuara Shteteve Palë me kërkesën që ato të vënë në dijeni atë nëse ato miratojnë një konferencë të Shteteve Palë me qëllim shqyrtimin dhe votimin e propozimit. Në rast se të paktën një e treta e Shteteve Palë miratojnë një konferencë të tillë, Sekretari i Përgjithshëm do të mbledhë konferencën nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Amendamentet e miratuara nga shumica e Shteteve Palë pjesëmarrëse dhe të botuara në konferencë do t'i paraqiten Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për miratim.

2. Amendamentet do të hyjnë në fuqi kur ato të miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe të pranohen nga dy të tretat e shumicës së Shteteve Palë në këtë protokoll në përputhje me proceset e tyre përkatëse konstitucionale.

3. Kur amendamentet hyjnë në fuqi, ato janë të detyrueshme mbi ato Shtete Palë që i kanë pranuar ato, mbi Shtetet e tjera Palë që janë akoma nën detyrimin e dispozitave të këtij protokoll dhe të ndonjë amendamenti të ri që ato kanë pranuar.

Neni 19

1. Ndonjë prej Shteteve Palë mund ta shpallë të pavlefshëm këtë protokoll në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi me shkrim adresuar Sekretariatit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Denoncimi do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Denoncimi duhet të bëhet duke mos paragjykuar zbatimin në vazhdim të dispozitave të këtij protokoll ndaj ndonjë komunikimi të paraqitur sipas nenit 2 ose në ndonjë hetim të filluar sipas nenit 8 para datës efektive të denoncimit.

Neni 20

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të informojë të gjitha shtetet për:

- a) nënshkrimet, ratifikimet dhe njohjen e këtij protokoll;
- b) datën e hyrjes në fuqi të këtij protokoll dhe për ndonjë amendament sipas nenit 18;
- c) ndonjë denoncim sipas nenit 19.

Neni 21

1. Ky protokoll, tekstet e të cilit në gjuhët arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle po ashtu autentike, do të depozitohet në arkivat e Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do t'u shpërndajë kopje autentike të këtij protokoll të gjitha shteteve duke iu referuar nenit 25 të Konventës.

REZOLUTË

a) Duke ndjekur në vazhdimësi marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Bashkimit European dhe zhvillimin e negociatave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe duke përshëndetur angazhimin e BE-së dhe të strukturave të tij në Bruksel e në Tiranë për kontributin e çmuar në këtë proces;

b) Duke evidentuar përpjekjet dhe progresin e bërë nga Shqipëria përmes hapjes zyrtare dhe zhvillimit të negociatave me BE-në për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit;

c) Duke konsideruar si realiste, nxitëse dhe programore qëndrimet kritike të BE-së në lidhje me mundësitë që ofron vendi ynë për garantimin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe nevojën për të përshpejtuar zbatimin e rekomandimeve të tij;

ç) Duke vlerësuar progresin relativ lidhur me stabilitetin politik dhe reformën zgjedhore, duke shprehur shqetësimin për konstatimet në raport se korrupsioni i përhapur dhe krimi i organizuar janë kërcënues për stabilitetin dhe se progresi i bërë në administratën publike është dëmтуar në disa raste të emërimeve politike dhe nepotike;

d) Duke shprehur shqetësimin për moszbatimin e Kushtetutës për kthimin dhe kompensimin e pronës private, që ka sjellë edhe mungesën e një tregu funksional për tokën e kapitalet dhe duke njohur se ka akoma hapësirë për përmirësimin në respektimin e të drejtave të njeriut;

dh) Duke vlerësuar mbajtjen nën kontroll të treguesve kryesorë makro-ekonomikë dhe të shqetësuar për uljen në rritjen ekonomike e në rendimentin financiar, krizën energjetike dhe mosrealizimet në procesin e privatizimit;

e) Duke njohur progresin zyrtar në kuadrin e stabilizim-asocimit, si dhe nevojën për më tepër përpjekje konkrete dhe të vendosura që Shqipëria duhet të tregojë për të konkluduar me sukses negociatat për stabilizim-asocimin;

ë) Duke vlerësuar se bashkëpunimi politik dhe institucional i të gjithë faktorëve është i domosdoshëm për zhvillimin e reformave afatgjata e integruese;

f) Në vazhdim të mbështetjes që i ka dhënë hapjes dhe vazhdimin të negociatave Shqipëri-BE për MSA;

g) Bazuar në rekomandimet e bëra nga Komisioni i BE-së në raportin e tij vjetor në adresë të të gjithë faktorëve institucionalë shqiptarë në procesin e integrimit european,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. I kërkon Qeverisë, në bashkëpunim me institucionet, forcat politike dhe shoqërinë civile, të shndërrojë Planin Strategjik për Integrim në Strategji Kombëtare për Integrim në Bashkimin European, i cili të detajojë, brenda muajit qershor 2003, të gjithë hapat që do të ndërmerren në përmbushje të të gjitha detyrimeve, si dhe plotësimin e standardeve që rrjedhin nga procesi i integrimit në fushën e reformave dhe përafrimit të legjislacionit.

2. I kërkon Qeverisë dhe forcave politike të përfaqësura në Kuvend, si dhe institucioneve të tjera përkatëse që, mbi bazën e propozimeve konkrete të bëra në Kuvend, veçanërisht nga opozita, brenda një periudhe 2-3 mujore, të marrin të gjitha masat administrative dhe nismat ligjvënëse për zgjidhje të përshpejtuar të çështjeve që lidhen me luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe reformën institucionale, të domosdoshme për shpejtimin e procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin European.

3. I kërkon Qeverisë dhe institucioneve të tjera konkretizimin dhe intensifikimin e përshpejtuar të proceseve të veprimit në fusha prioritare, si lufta kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme, korrupsionit, sidomos në fushat kyçe të sistemit gjyqësor, doganave dhe policisë, për të përmbushur kështu objektivat prioritarë në këtë drejtim, që kërkojnë vëmendje serioze 12 muajt e ardhshëm.

4. I kërkon Qeverisë të prezantojë në Kuvend programin e veprimeve për shpejtimin e reformës strukturore në ndërmarrjet e mëdha dhe ato strategjike, sidomos në sektorin financiar, për të përmirësuar legjislacionin tregtar në dobi të forcimit të konkurrencës dhe minimizimin e ekonomisë informale, për të rritur performancën në sektorët kyç të ekonomisë, si dhe mbledhjen e të ardhurave nga administrata fiskale.

5. Mbështet Presidentin e Republikës të ndërmarrë nisma konkrete dhe rezultative për reformën në drejtësi, me synim garantimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe luftën kundër korrupsionit.

6. Kërkon nga gjyqësori dhe prokuroria të zbatojnë me korrektësi ligjin kundër krimit dhe trafikeve të paligjshme, si dhe të mundësojnë dhënien e drejtësisë sipas ligjit për të gjithë shtetasit.

7. U kërkon institucioneve të tjera kushtetuese, Avokatit të Popullit dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, të kryejnë detyrat e tyre në forcimin e institucioneve, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi.

8. U bën apel partive politike të Shqipërisë të kontribuojnë në përmirësimin dhe forcimin e frymës së dialogut politik, bashkëpunimin institucional, garantimin e stabilitetit politik në vend dhe përfundimin me sukses të procesit të reformës zgjedhore.

9. Nxit përshejtimin e reformës në administratën publike, në përputhje me ligjin “Për shërbimin civil“, duke forcuar institucionet përgjegjëse, duke zgjeruar fushën e zbatimit të këtij ligji dhe garantuar zbatimin e kriterëve të tij në emërimet në administratë.

10. Rikonfirmon vullnetin për mbështetje legjislative dhe kontroll parlamentar për zbatimin e rekomandimeve të BE-së, veçanërisht në fushën e reformave ekonomike, zgjidhjen ligjore përfundimtare të kthimit dhe kompensimit të pronave, në përputhje me Kushtetutën dhe garantimin e plotë të të drejtave të njeriut dhe minoriteteve.

Tiranë, më 17 prill 2003

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbardimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 23.5.2003

Doli nga shtypi më 23.5.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë